



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Zyra e personelit

Nr. Prot: 599  
Datë: 22.2.2024

Mbështetur në nenin 79, paragrafi 1 dhe nën-paragrafi 7.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenin 8, nenin 10, nën-paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", shpall

**KONKURS**  
**për këto vende të lira pune me afat të caktuar**

- **Zyrtar i përkohshëm administrativ në Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës (UVP) 2024 (katër (4) punonjës) – për periudhë katër (4) mujore**

**Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligjet përkatëse, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:**

**Kriteret kryesore:**

1. Të kenë përgatitje shkollore superiore - fakulteti,
2. Të kenë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze,
3. Aftësi të mira të komunikimit,
4. Njohje të thelluar në programe të Microsoft Office si dhe njohuri bazike të programeve të dizajnit,
5. Të jenë në gjendje të punojnë me orar fleksibil si dhe nën presion.

**Detyrat – përgjegjësitë:**

- Regjistron studentët vendor në bazën e të dhënave;
- Ndihmon në vendosjen e studentëve dhe profesorëve në konvikte;
- Ndihmon në organizimin e ekskursioneve;
- Ndihmon në përditësimin dhe përgatitjen e materialeve të ndryshme për UVP;
- Bënë përgatitjen e forumeve dhe punëtorive;
- Mbanë evidencën e pjesëmarrësve në ligjërata;
- Asiston në përgatitjen e ceremonisë së hapjes dhe mbylljes së UVP;
- Përcjell dhe implementon agjendën e përgatitur për UVP;
- Kryen edhe punë të tjera që caktohen nga udhëheqësi.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Marrëdhënia e punës e nëpunësve themelohet me kontratën e punës për një periudhë të caktuar, respektivisht nga data **01.04.2024** deri **31.07.2024**.

**Afati i aplikimit:** Afati për paraqitjen e aplikimit nga kandidatët e interesuar do të jetë i hapur tridhjetë (30) ditë, pas shpalljes nga Njësia e Burimeve Njerëzore në ueb faqen e konkurrimeve të SIMBNJ dhe uebfaqen e Universitetit, gjegjësisht **nga data 23.02.2024 deri më 23.03.2024.**

**Dokumentacioni për aplikim:** Të interesuarit aplikacionin për konkurrim mund ta shkarkojnë përmes uebfaqes [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu) ose mund ta tërheqin në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Formularit për aplikim i duhen bashkëngjitur dëshmitë mbi përgatitjen dhe kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike, përvojën e punës etj.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në zyrën e arkivit qendror, nr. 18, në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Rr. “George Bush”, nr. 35, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t’i prezantojnë për verifikim dokumentet origjinale.

